

Shqipëria Aktualitet

Kontrolle blic në Shkodër/ Kishte fshehur në makinë armën e zjarrit, arrestohet 24-vjeçari, në pranga edhe tre të tjerë

February 2, 2022

0



Policia e Shkodrës ka vijuar kontrollet për parandalimin dhe goditjen e armëmbajtjeve pa leje si edhe kapjen e personave në kërkim.

Gjithashtu bëhet me dije se është arrestuar një 24-vjeçar, pasi gjatë kontrolleve në mjet i është gjetur e fshehur një armë zjarri automatike.

Më tej Policia e Shkodrës njofton se kuadër të kontrolleve në pranga kanë rënë M. C., 19 vjeç, banues në fshatin Grudë, Malësi e Madhe; M. L., 22 vjeç dhe A. G., 17 vjeç, të dy banues në fshatin Grudë e Re, Shkodër.

Këta shtetas janë konstatuar nga shërbimet e Policisë, në lagjen “Skënderbeg”, duke bërë lëvizje të dyshimta me mjetin “Volksëagen”.

Pas ndalimit, gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj këtyre shtetasve dhe kontrollit të automjetit u gjet një sasi lënde narkotike cannabis sativa.

Informacion-

Vijojnë kontrollet blic në të gjithë qarkun, për parandalimin dhe goditjen e armëmbajtjes pa leje, kapjen e personave në kërkim dhe të atyre që shpërndajnë lëndë narkotike.

Si rezultat i kontrolleve është kapur dhe arrestuar në flagrancë një shtetas që qarkullonte me armë zjarri në automjet.

Gjithashtu, janë arrestuar në flagrancë 3 shtetas të tjerë, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Në vijim të kontrolleve blic për parandalimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, kapjen e personave në kërkim dhe të atyre që shpërndajnë lëndë narkotike, nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafikeve dhe Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër u kap dhe u arrestua në flagrancë shtetasi:

A. Gj., 24 vjeç, banues në fshatin Prekal, Shkodër.

Shërbimet e Policisë kanë konstatuar dhe ndaluar në fshatin Golem, Shkodër, mjetin tip “Benz” me drejtues shtetasin A. Gj. Gjatë kontrollit të ushtruar në mjet është gjetur e fshehur një armë zjarri automatike, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale

Gjithashtu, gjatë kontrolleve të ushtruara në qytetin e Shkodrës, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër janë arrestuar në flagrancë shtetasit:

M.C., 19 vjeç, banues në fshatin Grudë, Malësi e Madhe; M. L., 22 vjeç dhe A. G., 17 vjeç, të dy banues në fshatin Grudë e Re, Shkodër.

Këta shtetas janë konstatuar nga shërbimet e Policisë, në lagjen “Skënderbeg”, duke bërë lëvizje të dyshimta me mjetin “Volksëagen”. Pas ndalimit, gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj këtyre shtetasve dhe kontrollit të automjetit u gjet një sasi lënde narkotike cannabis sativa.

U sekuestruan në cilësinë e provës materiale lënda narkotike, mjeti tip “Volksëagen” dhe 3 aparate celulare.

Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme.

TAGS Armë arrestim kontroll shkodër



Artikulli Parardhës

Tenton vetëvrasje, i riu hidhet nga kati i 5 i pallatit, rëndë në spital

Artikulli Pasardhës

Koalicioni ‘Shtëpia e Lirisë’ me Berishën, LSI i kthehet Bashës: Qylaxhiu Brava as që nuk do të ekzistonte pa ne. Do të ishte asgjësuar politikisht

ARTIKUJ TË NGJASHËM MË SHUMË NGA AUTORI

Këshillimi Kombëtar/ Rama fton qytetarët të japin mendimin e tyre dhe tregon shifrat, mbi 200 mijë përgjigje online dhe me postë

Gjendja civile do të përmirësojë shërbimet e ndërlidhjes, sistemi i ri rreth 2 milionë euro

Ikën SHÇBA, hyn në fuqi ligji i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

< >

KOMENTO

Koment:

Emri*

Email:*

Website:

☐ Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

Posto Komentin